



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE
M I N I S T R I

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Tiranë, Tel:270 630, Fax: 270 627

Tiranë, më 2/8/07

Mbi Strategjinë e zhvillimit të peshkimit dhe akuakultures në Shqipëri për periudhën 2007 – 2015.

(Fjala hyrese e mbajtur në Konferencën për prezantimin e Draft-Strategjisë)

I nderuar Zoti Kryeminister,
Te nderuar pjesëmarres

Në zbatim të Programit të Qeverisë, sot Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave prezanton Draft Strategjinë e Zhvillimit të Peshkimit dhe Akuakultures për periudhën 2007 – 2015.

Diskutimi dhe miratimi i këtij dokumenti do të shërbejë për të ndihmuar sektorin e peshkimit dhe akuakultures në zhvillimin e tyre si dhe do të përbejë një bazë të rëndësishme për formulimin, përshtatjen dhe miratimin e politikave të zhvillimit sektorial.

Potencialet e zhvillimit të sektorit të peshkimit dhe akuakultures në Shqipëri janë të mëdha. Ato përbehen nga një vijë bregdetare 474 km. e gjatë, nga burime të shumta ujore që rrjedhin në rreth 50 000 km lumenj dhe perrenj, nga një sipërfaqe e ujërave liqenore dhe e ujërave të tjera të brendshme prej 1100 km katrorë. Lidhja e deteve tona me hapasira të tjera detare jashtë ujërave tona territoriale përben një rezervë tjetër shumë të madhe për zenien dhe përpunimin e peshkut. Kthimi i këtyre potencialeve në një realitet prodhues, punësi, mirëqenieje dhe përmirësues të strukturës ushqimore të popullsisë e bën të domosdoshëm qartësimin e rrugëve të zhvillimit sektorial duke harmonizuar politikën, objektivat dhe vendimmarrjet afat shkurtër me ato afat mesëm dhe afat gjatë, harmonizimin dhe mbështetjen e zhvillimit të këtij sektori me dhe nga sektoret e tjera të ekonomisë shqiptare.

Aktualisht në Shqipëri vlera e prodhimit të peshkimit llogaritet në rreth 31 milion USD në vit. Prodhimi vjetor i peshkut arrin në rreth 7400 ton nga i cili rreth 2500 ton eksportohen. Disa mijëra veta janë të punësuar në zenien, rritjen, përpunimin dhe tregëtimin e peshkut. Ndërsa konsumi i peshkut për frymë të popullsisë është 3.3 kg/ vit nga rreth 15 kg/frymë/vit që konsumojnë vendet e rajonit mesdhetar. Këto tregues mund dhe duhet të jenë shumë

me te larte. Per kete duhen zgjidhur dhe kapercyer nje sere problemesh. Pikerisht kete synon kjo strategji qe po paraqesim.

Objektivat kryesore te strategjise deri ne vitin 2015 parashikojne qe Shqiperia te arrije nje prodhim peshku mbi 50 000 ton ne vit dhe mbi 5000 ton midhje dhe molusqe te tjera, eksporti i peshkut te fresket dhe te perpunuar te arrije ne rreth 12 000 ton. Konsumi pritet te rritet ne mbi 15 kg/ fryme/ vit, ne kete sektor te punesohen mbi 10 000 punonjes dhe te ardhurat e tij per ekonomine kombetare ti kalojne 150 milion euro ne vit.

Kater do te jene kollonat ku do te mbeshtetet konkretizimi i politikave dhe objektivave te kesaj strategjie ne termat afat shkurter, afat mesem dhe afat gjate duke perfshire periudhen deri ne vitin 2015. Ato jane:

- 1- Zhvillimi i shpejte dhe i diversifikuar i peshkimit detar;
- 2- Zhvillimi me ritme te shpejta i akuakultures sidomos i akuakultures detare;
- 3- Mbeshtetja e zhvillimit te industrise se perpunimit te peshkut;
- 4- Zhvillimi i shpejte i infrastruktures portuale dhe asaj te marketingut.

Strategjia parashikon qe Qeveria te mbeshtese me politika favorizuese zhvillimin e peshkimit detar duke e 5-6 fishuar sasine e zenies se peshkut deri ne vitin 2015. Kejo do te arrihet duke dyfishuar floten e peshkimit nga 250 aktualisht ne 500 anije, duke e rinovuar ate, duke rritur fuqine, sigurine dhe autonomine e lundrimit per te peshkuar edhe ne detrat e rajonit jashte ujrave tona territoriale, duke diversifikuar peshkimin perfshi edhe rikthimin tek tradita e peshkimit pellagjik e kryesisht te sardeles dhe acuges. Ky zhvillim do te mbeshtetet ne politika te favorshme te financimit me kredi dhe grante si dhe me zgjidhjen perfundimtare te furnizimit te anijeve me karburant sipas kriterëve dhe përvijës europiane.

Ne akuakulture parashikohet te behet nje revolucion i vertete, sidomos ne akuakulturen detare me kosha notues dhe impiante long-lines, si dhe ne akuakulturen ne ujerat e brendshme. Keto jane dhe do te jene nje sfide e se ardhmes te zhvillimit te sektorit duke patur si objektive qe se bashku me lagunat dhe ujembledhesit e bujqesise te realizohet nje prodhim vjetor mbi 20 000 ton peshk ne vit.

Rritjes se shpejte te prodhimit te peshkut parashikohet ti pergjigjet nje industri e fuqishme dhe cilesore sipas standarteve te Bashkimit European per perpunimin e peshkut duke synuar qe cdo vit te perpunohen mbi 10 000 ton.

Objektivat e mesiperme do te arrihen edhe duke plotesuar, permiresuar, fuqizuar dhe modernizuar infrastrukturen portuale per floten e peshkimit, bazen frigoriferike, zgjatjen e bankinave, ndertimin e shkalleve dhe ambienteve te tjera per riparimin e anijeve, thellimin e akuariumeve, ndertimin e merkatove te tregimit me shumice, etj. Nje varg investimesh jane kryer ne keto dy vjet ne Sarande, Vlore, Shengjin, Shkoder e ne zona te tjera dhe te tjera jane projektuar per tu ndertuar. Nje veper e madhe do te jete ajo e ndertimit te Portit te Ri te Peshkimit ne Durres per te cilin jane siguruar fondet. Ne javet e ardheshme do te filloje puna per hartimin e projektit dhe i gjithe porti do te jete gati ne fund te vitit 2009.

Sigurisht qe Strategjia parashikon edhe masa te tjera qe kane te bejne me plotesimin e kuadrit ligjor bazuar ne direktivat e Bashkimit European, parashikohet konsolidimi dhe fuqizimi i Organizatave te Manaxhimit te Peshkimit, rritja e kualifikimit te punonjesve te sektorit te peshkimit e shume masa te tjera.

I nderuar Zoti Kryeminister
Te nderuar pjesmarres,

Kjo Strategji, e cila eshte e para qe hartohet per kete sektor, synon te ridimensionoje vlerat dhe peshen shumefaktoriale te sektorit te peshkimit ne kuader te ekonomise kombetare. Hartimi i saj eshte kontribut i bashkepunimit te specialisteve te sektorit te peshkimit ne gjithë strukturat administrative dhe shkencore te vendit me specialistet dhe konsulentet e huaj qe jane angazhuar nga Projekti Pilot i Peshkimit qe financohet nga Banka Boterore. Drafti i eshte neneshtuar nje sere konsultimesh dhe diskutimesh me grupet e interesit dhe strukturat respektive. Me kete rast do te doja te falenderoj gjithë specialistet te vendit dhe te huaj si dhe perfaqesuesit e Bankes Boterore per kontributin e dhene ne hartimin e dokumentit te Strategjise. Pas reflektimit te sygjerrimeve dhe verejtjeve eventuale, ky draft do te paraqitet per miratim ne Keshillin e Ministrave per tu kthyer ne nje pjese te rëndesishme te Strategjise Integrale te Ekonomise Shqiptare. Me kete dokument ne hedhim bazat per nje hap te ri perpara per nje sektor i cili ze nje vend te rëndesishem ne procesin e integritimit europian te Shqiperise.

Ju faleminderit

Lufter XHUVELI

Minister